

VENDIM
Nr.602, datë 24.8.2011

PËR MIRATIMIN E MËNYRËS SË PËRDORIMIT TË FONDEVE KUNDËRPARTI, TË MBLEDHURA NGA GRANTET JAPONEZE PËR SEKTORIN E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondet kundërparti, të dhëna nga qeveria japoneze dhe të mbledhura nga Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, si agjenci e pagesave, në shumën 200 000 000 (dyqind milionë) lekë, të derdhen në buxhetin e shtetit.

2. Këto fonde të përdoren gjatë vitit 2011 nga AZHBR-ja në formën e kredimit pa interes, me qëllim nxitjen dhe rritjen e prodhimit bujqësor e blegtoral, si dhe përpunimin e këtyre produkteve.

3. Vlerat monetare, që do të përdoren për mbështetjen e zhvillimit bujqësor, do të jenë në përpjestim me masën e investimit të vetë përfituesit.

4. Me këto fonde të financohen investimet për:

a) blerjen dhe instalimin e dhomave frigoriferike;
b) linjat e seleksionimit dhe të përpunimit të prodhimit të arroveve, gështenjës dhe shegës;
c) ndërtimin apo modernizimin e komplekseve blegtorale dhe instalimin e impianteve të tyre ndihmëse;

ç) blerjen e mekanikës bujqësore;

d) ngritjen e serrave për prodhimin e fidanëve të arrës.

Masa e financimit për këto veprimtari, nga këto fonde investimi, do të jetë në varësi të llojit dhe të vlerës së investimit:

a) Deri në 60% të vlerës së përllogaritur të investimit, por jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) milionë lekë, për ngritjen e dhomave frigoriferike;

b) Deri në 80 % të vlerës së përllogaritur të investimit, por jo më shumë se 35 (tridhjetë e pesë) milionë lekë, për blerjen e linjave të reja ose rinovimin e linjave ekzistuese të seleksionimit, ruajtjes dhe përpunimit të arroveve, gështenjës dhe shegës;

c) Deri në 50% të vlerës së përllogaritur të investimit, por jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) milionë lekë, për ndërtimin apo modernizimin e komplekseve blegtorale, për prodhimin e qumështit e të mishit, si dhe instalimin e impianteve të tyre ndihmëse;

ç) Deri në 8 (tetë) milionë lekë, për investimet në blerjen e mekanikës bujqësore;

d) Deri në 80% të vlerës së përllogaritur të investimit, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) milionë lekë, për ngritjen e serrave për prodhimin e fidanëve të arrës.

6. Këto vlera monetare do të lëvrohen për të mbështetur zhvillimin e veprimtarive të mësipërme në formën e kredive pa interes, me afat maturimi 7–vjeçar.

7. Procedura, kriteret e përfitimit të kredisë dhe mënyra e administrimit të fondit të përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të Ministrit të Financave.

8. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha